

IMPACT OF SUSTAINABLE DEVELOPMENT IN IMPROVING HUMAN DEVELOPMENT ASPECTS

Msc. Dorina Ciko

“Eqrem Çabej” University, Economic Department,
Gjirokastra, Albania
E-mail: dorinaciko@yahoo.com

Msc. Bitila Zhuli

“Eqrem Çabej” University, Economic Department,
Gjirokastra, Albania
E-mail: tilazhuli@yahoo.com

Dr.Msc Sahit Surdulli

“Globus” College University, Prishtina, Kosovo
sahit.surdulli@rks-gov.net

***Abstract** Albania is a developing country in the Western Balkan region. The country is committed to meeting the Millennium Development Objectives towards making radical improvements in levels of poverty, health, education, respect of human rights, promotion of gender equality and ensuring environmental sustainability. The paper will focus on providing a view of some aspects of sustainable development and some basic aspects of human development as: possibility of a long and healthy life, education level and a good standard of living.*

The main purpose of the paper is the identification of the link between sustainable development and some basic aspects of human development specifically focusing on how sustainable development affects their improvement. This paper will be achieved through methods of qualitative and quantitative empirical research. Finally the paper will close with some conclusions and recommendations.

***Keywords:** sustainable development, education, poverty, welfare, HDI*

***Abstrakt** Shqipëria është një vend në zhvillim në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Vendi është angazhuar për të përmbushur Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (OZHM) në drejtim të bërjes së përmirësimeve rrënjësore në nivelet e varfërisë, në shëndet, në arsim, në respektimin e të drejtave të njeriut dhe promovimin e barazisë gjinore si dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë mjedisore. Punimi do të fokusohet në dhënien e një pamjeje të qartë të disa aspekteve të zhvillimit të qëndrueshëm dhe disa aspekteve themelore të zhvillimit njerëzor si: mundësia e nje jete të gjatë dhe të shëndetshme, niveli arsimor dhe një standart i përshtatshëm jetese.*

Qëllimi kryesor i punimit është evidentimi i lidhjes midis zhvillimit të qëndrueshëm dhe disa aspekteve themelore të zhvillimit njerëzor pra më konkretisht sesi zhvillimi i qëndrueshëm ndikon në përmirësimin e tyre. Ky punim do të realizohet me ane të metodave empirike cilesore dhe sasiore. Në fund punimi do të mbyllet me disa konkluzione dhe rekomandime.

***Fjalë kyçe:** zhvillim i qendrueshem, edukim, varfëria, mirëqënie, IZHNJ*

1. Hyrje

Tradicionalisht, koncepti i zhvillimit është shqyrtuar ekonomikisht ku zhvillimi është parë si një pjesë e procesit të prodhimit. Shumica e ekonomive kanë pranuar dobishmërinë e këtij vlerësimi të zhvillimit nga pikëpamja ekonomike, por kjo është e pamjaftueshme për të kuptuar nivelin social dhe kulturor të një vendi. A përbën ky matës tradicional një matës të përshtatshëm për mirëqënien ekonomike të një shoqërie? Para së gjithash, një matje e saktë e mirëqënies ekonomike të një shoqërie do të kërkonte të mbahej parasysh edhe shpërndarja e produktit të përgjithshëm sipas grupeve të ndryshme shoqërore. Gjithashtu, në treguesit tradicional përfshihen një varg produktesh, që në vetvete konsiderohen se kontribuojnë në rritjen e mirëqënies së shoqërisë, por që prodhimi apo konsumi i të cilëve mund të shoqërohet me dëmtimin e mjedisit, të shëndetit të njerëzve, etj. Njerëzit shpesh vlerësojnë arritjet që nuk shfaqen në shifrat e të ardhurave ose të rritjes ekonomike si cilësinë më të mirë të jetesës, shkollimin, cilësinë në të ushqyerit dhe shërbime më të mira shëndetësore, jetesë më të sigurt, kohën e lirë, liritë politike dhe kulturore si dhe pjesëmarrjen në aktivitetet e komunitetit. Objektivi i zhvillimit është për të krijuar një mjedis të përshtatshëm për njerëzit të gëzojnë jetë të gjatë, të shëndetshme dhe krijuese. Që të sigurohet përmirësimi i cilësisë së jetës do të duhet ti jepet rëndësia e duhur zhvillimit të qëndrueshëm duke e përfshirë në matësit tradicional jo vetëm ato të matshme nga pikëpamja monetare por edhe ato me natyrë jomonetare. Kështu, fokusi kryesor i punimit tonë do të jetë se si duhet të orientohet zhvillimi në përpjekje për përmirësimin e mirëqënies nëpërmjet përfshirjes së aspekteve të zhvillimit njerëzor. Gjithashtu, në punim do të ndalemi në një analizë krahasuese të disa treguesve të zhvillimit njerëzor në Shqipëri me vendet e tjera të Ballkanit.

2. Evoluimi i konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm dhe i disa aspekteve të zhvillimit njerëzor

2.1. Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm

Koncepti i zhvillimit të qëndrueshëm ka lindur në fund të viteve 1980 si një përgjigje ndaj zhvillimit ekonomik i cili nuk kishte në konsideratë mbrojtjen e burimeve natyrore dhe mjedisit. Kështu më 1986-n, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së sanksionoi për herë të parë të drejtën e zhvillimit, e cila është një e drejtë e detyrueshme që çdo person human dhe të gjithë popujt kanë të drejtë të marrin pjesë dhe kontribuojnë në zhvillimin ekonomik, social, kulturor dhe politik, në të cilën çdo e drejtë e të qenët human e të gjitha liritë themelore mund të realizohen plotësisht.

Edhe pse nuk ekziston një përkufizim i pranuar universalisht, Komisioni Botëror për Zhvillimin Ekonomik (WCED- World Commission on Economic Development) sugjeroi në Raportin e Brundtland përkufizimin "*zhvillimi që plotëson nevojat e së tashmes pa rrezikuar aftësinë e brezave të ardhshëm për të plotësuar nevojat e tyre*"

(WCED 1987). Raporti Brundtland është raporti i parë hulumtues i cili ka theksuar tri komponentë thelbësorë të zhvillimit të qëndrueshëm: mbrojtje mjedisore, rritje ekonomike dhe barazi shoqërore.

Me shqetësimin për mjedisin termi zhvillim i qëndrueshëm u bë një temë e përbashkët për shumë kërkime në vitet 1990. Nocioni i zhvillimit të qëndrueshëm është zgjeruar duke u zbatuar në shumë fusha të aktivitetit ekonomik. Kështu, sipas (WTO, 1993) zhvillimi i qëndrueshëm është *"një proces i cili kërkon ndodhjen e zhvillimit pa degradimin dhe harxhimin e burimeve të cilat në fund të fundit mundësojnë zhvillimin, duke bërë që në këtë mënyrë burimet të aftësojnë brezat e ardhshëm po aq mirë sa edhe brezat e tanishëm"*.

Zhvillimi i qëndrueshëm kërkon që rritja ekonomike të ndodhë në një mënyrë ekologjikisht të shëndetshme dhe shoqërisht të barabartë. (Swarbrooke, 2002) Zhvillimi i qëndrueshëm kryesisht ka të bëjë me përmirësimin e kualitetit jetësor duke u kujdesur për kohëzgjatjen e kapacitetit të Tokës. Siguria njerëzore, prosperiteti dhe mirëqënia varen nga një mjedis i shëndoshë. Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, mbrojtja nga ndotja dhe ruajtja e vendbanimeve natyrore janë esenciale që të zvogëlohet varfëria dhe të përmirësohet cilësia e jetës.

2.2. Disa aspekte të zhvillimit njerëzor

Zakonisht, koncepti i zhvillimit është shqyrtuar ekonomikisht ku zhvillimi është parë si një pjesë e procesit të prodhimit. Kështu, propozimet mbi zgjidhjen janë fokusuar në mënyrën se si faktorët e prodhimit mund të merren dhe se si ato mund të përdoren në procesin e prodhimit (Yavilioğlu 2002). Shumica e ekonomive kanë pranuar dobishmërinë e këtij vlerësimi të zhvillimit nga pikëpamja ekonomike, por kjo është e pamjaftueshme për të kuptuar nivelin social dhe kulturor të një kombi. Në këtë mënyrë, zhvillimi duhet parë si një proces shumëdimensional i cili sjell ndryshime të rëndësishme në sjelljet shoqërore, strukturat dhe institucionet kombëtare. Zhvillimi mund të vlerësohet si një proces i vazhdueshëm i rritjes dhe i zgjerimit të zgjedhjes njerëzore duke shtrirë potencialin njerëzor. Në parim, këto zgjedhje mund të jenë të pafundme dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Si i tillë zhvillimi nuk do të thotë vetëm ndryshime revolucionare por nënkupton ekzistencën e një procesi që ka për qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës së individit dhe shoqërisë. Në këtë mënyrë në qendër të këtij procesi vendosen njerëzit dhe zhvillimi duhet të bazohet në liritë, arritjet dhe aftësitë e tyre. (Anand dhe Sen, 1994). Sot, zhvillimi nuk ka të bëjë vetëm me ecurinë ekonomike, por më tepër orientohet te njerëzit dhe te mirëqenia e tyre. Zhvillimi njerëzor sic ka theksuar Jahan (2005) është i popullit, për popullin dhe nga populli. I pari i referohet formimit të burimeve njerëzore nëpërmjet të ushqyerit, shëndetit dhe arsimit. Zhvillimi për popullin thekson se përfitimet e rritjes ekonomike duhet të jenë të përkthyer në jetën e njerëzve. Zhvillimi nga populli do të thotë se njerëzit duhet të jenë në gjendje të ndikojnë në procesin, i cili ndikon në jetën e tyre.

Përpjekjet e para për vlerësimin e zhvillimit jo vetëm nga ana ekonomike por gjithashtu edhe nga përmirësimet në mirëqënien e njerëzve datojnë në vitin 1990 ku Raporti i parë i Zhvillimit Njerëzor është iniciuar nga Mahbub ul Haq i cili ka pasur një qëllim të qartë: " për të zhvendosur fokusin e zhvillimit ekonomik nga llogaritja e të ardhurave kombëtare drejt politikave të përqendruara te njerëzit" (Mahbub ul Haq 1995). Sen (1989) argumenton se, shpesh njerëzit vlerësojnë arritjet që nuk shfaqen në shifrat e të ardhurave ose të rritjes ekonomike. Zhvillimi njerëzor mund të vij si rezultat i një aksesit më të madh në njohuri, në të ushqyerit dhe shërbime më të mira shëndetësore, në jetesë më të sigurt, në siguri kundër krimit dhe dhunës fizike, në kohën e lirë, në liritë politike dhe kulturore si dhe në pjesëmarrjen në aktivitetet e komunitetit. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor (Human Development Index - HDI) është një metodë e standartizuar në vlerësimin dhe matjen e mirëqënies së një popullsie e cila është përdorur për herë të parë më 1990 në Raportin e Zhvillimit Njerëzor të botuar nga programi për Zhvillim i OKB-së (UNDP). Ajo ofron një alternativë për vlerësimin e progresit të një vendi në aspektet e zhvillimit njerëzor. Indeksi i Zhvillimit Njerëzor ka pasur një ndikim të rëndësishëm në tërheqjen e vëmendjes së qeverive, korporatave dhe organizatave ndërkombëtare për aspekte të zhvillimit që të përqëndrohen jo vetëm në të ardhurat por në zgjerimin e zgjedhjes dhe të lirive.

HDI kombinon tre dimensione:

- Jetëgjatësia në lindje, një tregues i shëndetit dhe jetëgjatësisë së popullatës.
- Dija dhe edukimi, të matura nga shkalla e analfabetizimit të të rriturve dhe mesatarja e viteve të shkollimit
- Standardi i jetesës, i matur nga prodhimi kombëtar bruto për frymë.



Figura 1 Dimensionet e Indeksit të zhvillimit njerëzor

3. Aspekte të zhvillimit njerëzor në shtetet e Ballkanit

3.1. Një informacion i shkurtër mbi Shqipërinë

Shqipëria, në vitet e fundit ka ecur në rrugën e përparimit në përpjekje për tu orientuar drejt zhvillimit dhe për të qënë pjesë e Bashkimit Evropian. Përgjatë këtyre viteve të tranzicionit ka pasur një zhvillim ekonomik të pakontestueshëm, ku GDP-ja kaloi nga 2.2 miliardë dollarë në 1990-n, në rreth 13 miliardë në 2013-n. Përvoja tranzicionit është ndikuar vecanërisht nga dy momente të mëdha të krizës ekonomike dhe sociale. E para lidhet me rënien e regjimit komunist në fillim të viteve 1990, me shpërbërjen e tërë kompleksit industrial, shkatërrimin e shumë shërbimeve dhe valët e mëdha të emigracionit. Momenti i dytë i krizës ekonomike, i cili solli pasoja politike dhe institucionale, ishte rënia e skemave financiare piramidale në fillim të vitit 1997, të cilat shkatërruan një pjesë të madhe të kursimeve të individëve dhe zgjeruan varësinë financiare ndërkombëtare të Shqipërisë. Pavarësisht dy krizave, në procesin e saj të transformimit Shqipëria ka proceduar më shpejt se në vendet e tjera.

Rritja ekonomike në Shqipëri mund të konsiderohet relativisht të kënaqshme për një periudhë 10-vjecare, nga viti 2000 deri në 2010, sidomos duke pasur parasysh krizën e vazhdueshme ekonomike dhe flukset e migrimit të popullsisë. Edhe pse ritmet e rritjes gjatë viteve të fundit kanë qënë mjaft të larta, ritmi i përgjithshëm i rritjes që nga fillimi i tranzicionit është modest. Në fakt, pjesa më e madhe e rritjes ka qënë rimëkëmbje nga rëniet ekonomike e ndikuar vecanërisht nga flukset hyrëse tepër të larta të remitançave, rritja e turizmit dhe eksporteve e kombinuar kjo me rritjen e nivelit të lëvizjeve të brendshme nëpërmjet investimeve dhe bizneseve të reja. Megjithatë, të dhënat ende pasqyrojnë një vend kontradiktash ku varfëria, ekzistenca e pabarazive dhe lëvizjeve të konsiderueshme të popullsisë si jashtë dhe brenda vendit mbeten shqetësime kryesore.

3.2. Analizë krahasuese e disa treguesve të zhvillimit njerëzor në vendet e rajonit.

Që nga fillimi i viteve 1990, vendet e Ballkanit kanë ndryshuar në aspektin shoqëror, ekonomik dhe politik. Megjithatë, këto vende kanë dallime të rëndësishme në aspektet e zhvillimit njerëzor .

Në punim do të analizojmë komponentët kryesor të Indeksit të zhvillimit njerëzor (HDI-Human Development Index) të vendeve të rajonit. Të dhënat e përdorura i referohen Raporteve të Zhvillimit Njerëzor publikuar nga UNDP për vitet e marra në analizë (2000-2013).

Duke iu referuar Raportit më të fundit (korrik 2014) të Zhvillimit Njerëzor publikuar nga UNDP, Shqipëria pozicionohet midis vendeve me zhvillim të lartë njerëzor dhe është e 95-ta midis 187 vendeve. Nëse i referohemi rajonit ajo renditet e fundit. Sllovenia kryeson listën e vendeve të rajonit që janë marrë në shqyrtim me një

indeks 0.874 e cila pasohet nga Greqia dhe Kroacia ku të tria bëjnë pjesë në vendet me zhvillim shumë të lartë njerëzor.

Tabela 1 Dimesionet e Indeksit të zhvillimit njerëzor në 2013¹

Shtetet	HDI (2013)	Jetëgjatësia në vite (2013)	Vitet e shkollimit në vite (2012)	Vitet e pritura të shkollimit në vite (2012)	GNP për frymë në \$ (2013)
Bosnjë-Herzegovina	0.731	76.4	8.3	13.6	9431
Bullgari	0.777	73.5	10.6	14.3	15402
Greqi	0.853	80.8	10.2	16.5	24658
Kroaci	0.812	77	11	14.5	19025
Mali i Zi	0.789	74.8	10.5	15.2	14710
Maqedoni	0.732	75.2	8.2	13.3	11745
Rumani	0.785	73.8	10.7	14.1	17658
Serbi	0.745	74.1	9.5	13.6	11301
Shqipëri	0.716	77.4	9.3	10.8	9225
Slovenia	0.874	79.6	11.9	16.8	26809
Turqi	0.759	75.3	7.6	14.4	18391

Burimi: UNDP




Figura 2 Trendi i HDI- Indeksi të zhvillimit njerëzor 2000-2013

Burimi: UNDP

Nqs i referohemi trendit të indeksit për vitet 2000-2013 shohim se kemi një përmirësim në drejtim të aspekteve të zhvillimit njerëzor. Nga viti 2000 deri në vitin

¹ Duke filluar nga viti 2010, në Raportet e Zhvillimit Njerëzor të UNDP filloi të përdorej një metodë e re në llogaritjen e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor.

Index i $x = \frac{x - \min(x)}{\max(x) - \min(x)}$ ku $\min(x)$ dhe $\max(x)$ janë vlerat më të ulëta dhe më të larta që variabla x mund të marrë. HDI pastaj përfaqëson një shumë uniformë $\frac{1}{3}$ e kontribuar nga secili prej këtyre treguesve. HDI = (Ind i jetëgjatësisë x Ind i Edukimit x Ind i standartit të jetesës)/3

2013, vlera e HDI-së në Shqipëri është rritur nga 0,655 në 0,716 një rritje prej 9.3 për qind ose një rritje mesatare vjetore prej 0,7 për qind. Në këtë periudhë dhe midis vendeve të marra në shqyrtim rritjen mesatare vjetore më të madhe e ka pasur Turqia 1.16 për qind.




Figura 3 Indeksi i Jetëgjatësisë Burimi²: UNDP

Përsa i përket Indeksit të jetëgjatësisë shohim se kemi një përmirësim të dukshëm të këtij treguesi. Greqia ka indeksin më të lartë të jetëgjatësisë. E cila pasohet nga Sllovenia, Kroacia dhe Shqipëria. Ndërsa Rumania dhe Bullgaria kanë vlerën më të ulët të këtij indeksi.




Figura 4 Indeksi i Edukimit³

² Indeksi i jetëgjatësisë = $\frac{LE-20}{85-20}$ ku LE- (Life expectancy at birth) e matur në numër vitesh.

³ Indeksi i Edukimit = $\frac{MYSI+EYSI}{2}$ ku MYSI- (Mean Years of Schooling Index)= MYS/15 ku MYS mat mesataren e viteve të shkollimit që një 25 vjecar ose më i vjetër ka kaluar në shkollë. Ndërsa EYSI- (Expected Years of Schooling Index)= EYS/18 ku EYS mat vitet e pritura të shkollimit pra vitet që një fëmijë 5 vjecar do të kalojë me arsimin në të gjithë jetën.

Nqs i referohemi Indeksit të Edukimit në listën e vendeve të marra në shqyrtim listën e kryeson Sllovenia, ku ndiqet nga Greqia. Në fund të listës me vlerën më të vogël të këtij indeksi prej 0.61 qëndron Shqipëria.




Figura 5 Indeksi i standartit të jetesës⁴

Duke iu referuar Indeksit të standartit të jetesës, listën e kryeson Sllovenia e cila pasohet nga Greqia. Shqipëria ka vlerën më të ulët të këtij indeksi

4. Konkluzione

Vendi yne, si nje nder vendet e Ballkanit qe aspiron integrimin European ka treguar se ka nje zhvillim njerezor relativisht te qendrueshem. Trendi i ketij zhvillimi ka qene ne rritje per periudhen 2000-2013. Kjo i referohet analizes se indeksit te zhvillimit njerezor, bazuar ne Raportin më të fundit (korrik 2014) të Zhvillimit Njerëzor publikuar nga UNDP.

Nëse i referohemi rajonit te Ballkanit, Shqipëria renditet nder vendet e fundit. Sllovenia kryeson listën e vendeve të rajonit, e cila pasohet nga Greqia dhe Kroacia ku të tria bëjnë pjesë në vendet me zhvillim shumë të lartë njerëzor.

Nga analiza e indekseve Shqipëria pozicionohet me nje indeks mesatar relativisht te mire per jetgjatesine , ndersa persa i perket indeksit te edukimit dhe standartit te jeteses jemi vendi i fundit ne Ballkan per periudhen e marre ne shqyrtim.

Ne kete prizem vendi yne edhe pse ka hedhur hapa ne permiresimin e indeksit te jetegjatesise, edukimit dhe standartit te jeteses ka ende shume pune per te bere ne rritjen dhe permiresimin e zhvillimit njerezor.

⁴ Indeksi i standartit të jetesës = $\frac{\ln(GNIpc) - \ln(100)}{\ln(75000) - \ln(100)}$ ku GNIpc- Gross National Income at purchasing poër parity.

Zhvillimi i qëndrueshëm rrjedhimisht kërkon që rritja ekonomike të ndodhë në një mënyrë ekologjikisht të shëndetshme dhe shoqërisht të barabartë duke përmirësuar kualitetin jetësor. Siguria njerëzore, prosperiteti dhe mirëqënia varen nga një mjedis i shëndoshë. Përdorimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore, mbrojtja nga ndotja dhe ruajtja e vendbanimeve natyrore janë esenciale që të zvogëlohet varfëria dhe të përmirësohet cilësia e jetës.

Hapat dhe trendi i deritanishëm tregojnë rritje pozitive dhe potenciale zhvillimi të cilat nëse pershpejtohen do të pozicionojnë Shqipërinë në nivelet e vendeve të zhvilluara të rajonit Ballkanik.

5. Referencat

Yavilioğlu, C. (2002). The Semantic History of Concept of the Development and its Conceptual Origins. Cumhuriyet Üniversitesi.

Anand, S. & Sen, A. K. (1994). Human Development Index: Methodology and Measurement. Working Paper 12. UNDP. New York: Human Development Report Office.

Sen, A. K. (1989). Development as Capabilities Expansion. Journal of Development Planning. 19: 41-58.

Altay, H. & Şen, A. Analysis of Human Development in Balkan Countries: A Comparison of East and Middle Europe Countries. 2nd International Symposium on Sustainable Development, June 8-9 2010, Sarajevo.

Swarbrooke, J. (2002) Sustainable Tourism Management.

Haq, Mahbub ul.. (1995). Reflections on Human Development. New York: Oxford University Press

Jahan, S.(2005). Measuring Human Development: Evolution of the Human Development Index.

WCED (1987). Our common future. Oxford: Oxford University Press

Fukuda-Parr, S. (2003). The Human Development Paradigm: operationalizing Sen's ideas on capabilities. Feminist Economics, Vol. 9, No. 2 – 3, 301-317.

UNDP. Human Development Report (2000-2013)

<http://hdr.undp.org/en/data>

<http://hdr.undp.org/en/content/table-2-human-development-index-trends-1980-2013>